UDHËZIM
Nr.39, datë 6.10.2011

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER SHKENCOR/MASTER I ARTEVE TË BUKURA", NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, "Master profesional", për vitin akademik 2011-2012", vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve "Master shkencor/master i arteve të bukura", për vitin akademik 2011-2012", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 "Për kryerjen nga "Posta Shqiptare" sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror",

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë, "Master profesional" dhe "Master shkencor/master i arteve të bukura", në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Aplikantët fitues përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë në bazë të kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë, "Master profesional" dhe "Master shkencor/master i arteve të bukura". Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vijojnë programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" dhe "Master shkencor/master i arteve të bukura", datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

5. Aplikimet për regjistrim në programet e studimit të ciklit të dytë, "Master profesional" dhe "Master shkencor/master i arteve të bukura", të bëhet pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, nga data 10.10.2011 deri në datë 15.10.2012, prej orës 08:00 deri në orën 18:00, ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve, të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2500 lekë, paguar në "Postën Shqiptare";

e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi të ciklit të dytë, "Master profesional" dhe "Master shkencor/master i arteve të bukura", në institucionet e

arsimit të lartë publik.

6. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë të ngrihen komisione *ad-hoc* sipas fushave përkatëse, për përzgjedhjen e aplikantëve fitues në përputhje me kriteret e pranimit të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16.00 të datës 22.10.2011, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara sipas vendimit nr.672, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, "Master profesional", për vitin akademik 2011-2012", si dhe vendimit nr.652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve "Master shkencor/master i arteve të bukura", për vitin akademik 2011-2012".

8. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 24.10.2011 deri në datën 28.10.2011 prej orës 08:00 deri në orën 18:00 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të paraqesë në origjinal dokumentet sipas shkronjës "a" dhe "b" të pikës 5 të këtij udhëzimi.

9. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare origjinale me regjistrimet e kryera brenda datës 10.11.2010, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

10. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj